



REPUBLIKA SHQIPERISE
KESHILLI BASHKIAK
BASHKIA DURRES

Adresa : Sheshi "Liria", Durres

Tel/ fax: 00355 52 22310 / 23454

PROJEKT -VENDIM

NR _____ DATE _____

Per Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore ne qytetin e Durrësit

Në mbështetje të ligjit nr. 8652 dt.31/07/2000 " Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore " i ndryshuar, Ligjit nr.9632, datë 30/10/2006 " Për sistemin e taksave vendore " i ndryshuar, Ligjit nr. 9920 date 19/05/2008 " Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise ", i ndryshuar, Ligji nr. 9975 date 28.07.2008 "Per taksat kombetare" i ndryshuar, Ligji nr.9723 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", i ndryshuar, Ligjit Nr.8378 dt 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës se Shqiperise" i ndryshuar, Vendimeve te Keshillit te Ministrave dhe te gjitha akteve te tjera nenligjore per zbatimin e ligjeve te sipercituara, dhe Vendimi i Keshillit Bashkiak nr.57 date 26/12/2007 " Per sistemin e taksave dhe tarifave vendore ne qytetin e Durrësit " i ndryshuar, Kryetari i Bashkise i propozon Keshillit Bashkiak,

KESHILLI BASHKIAK

VENDOSI

1. Miratimin e sistemit te taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit per vitin 2012 si me poshte vijon:

1.TAKSAT VENDORE

Llojet, baza tatimore, kategorizimet dhe nënkategorizimet, këstet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese dhe agjenti tatimor.

Bashkia Durrës, Dhjetor 2011

1.1. TAKSA VENDORE MBI BIZNESIN E VOGËL

Biznes është çdo veprimtari ekonomike nga çdo subjekt, që ka për qëllim realizimin e fitimit. Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me ane të të cilit realizohet, gjate vitit fiskal, një e ardhur bruto vjetore (qarkullim) me e vogël ose e barabarte me 8,000,000 (tete milion)leke, quhet Biznes i Vogël.

Taksa vendore mbi biznesin e vogël llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit, qofte ky subjekt fizik apo juridik, vendas apo i huaj, me ane të cilit realizohet një e ardhur bruto vjetore (qarkullim) me e vogël ose e barabarte me 8 000 000 leke.

Taksa paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiskal.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës vendore mbi biznesin e vogël është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, pranë Bashkisë Durrës.

Kategoritë e bazës dhe nivelet e taksës vendore mbi biznesin e vogël paraqiten ne aneksin Nr.1

1.2. TAKSA MBI PASURITE E PALUAJTSHME

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë të pasurive të mësipërme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron. Në taksën mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- Taksa mbi ndërtesat.
- Taksa mbi tokën bujqësore.

1.2.1. TAKSA MBI NDËRTESEN

Taksa mbi ndërtesën llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit

Baza e taksës mbi ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Sipërfaqja në pronësi të taksapaguesit përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë këtë pronësi dhe ne rastin e mungesës se dokumentacionit Këshilli i Bashkisë ngre komisionin e verifikimit të pasurive të paluajtshme i cili verifikon madhësinë e sipërfaqes së tatueshme. Zyra e taksave njeh si dokumentacion nje nga dokumentacionet e meposhteme :

- a) vërtetimin e pronësisë
- b) vendimet e komisionit të kthimit të pronave
- c) vendimet e privatizimit
- d) vetëdeklarimin
- e) vendimet e komisionit të verifikimit të pasurive të paluajtshme.

Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori minimale të bazës për taksën mbi ndërtesën është si vijon.

Kategoritë dhe nënkategoritë	Lekë/m2/vit
I. NDËRTESA BANIMI	
<i>Ndërtuar para 1993 – shit</i>	
Ndërtesa banimi	12
<i>Ndërtua pas 1993 – shit</i>	
Ndërtesa banimi	25
II. NDËRTESA TË TJERA	
<i>Ndërtesa për tregti dhe shërbime</i>	
- Ndërtesa për shërbime tregtare, administrative te ngjashme me to etj	200
- Ndërtesa prodhimi	140
- Te tjera	200
- Ndërtesat në pronësi të organizatave jofitimprurëse, fondacioneve	50
- Objekte të rrënuara dhe jashtë funksionit kur janë objekte te ndërtimeve shtetërore dhe ish ndërmarrje shtetërore te privatizuar ku nuk zhvillohet aktivitet.	

Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor.

Ne nënkategorinë e II Ndërtesa te tjera përfshihen:

II-2. Zëri ndërtesa te tjera

- Me ndërtesa ne pronësi te organizatave jo fitimprurëse, fondacioneve:
Do te kuptojmë pronat te cilat përdoren nga organizatat jo fitimprurëse, vendase dhe te huaja, zyrat e përfaqësimit te organizmave ndërkombëtare.
- Me objekte te amortizuara, te dëmtuara dhe jashtë funksionit kur janë objekte te ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-ndërmarrjeve shtetërore te privatizuar ku nuk zhvillohen aktivitete:
Do te kuptojmë te gjithë objektet, te cilat janë kapital i ndërmarrjeve shtetërore dhe kane qene kapital i ish-ndërmarrjeve shtetërore
- Kur është objekt i ndërmarrjeve shtetërore ekzistuese te cilat janë tërësisht te amortizuara (vlera e amortizimit mbi 80% e vlerës fillestare dhe ndryshimeve përkatëse sipas pasqyrave kontabël) ose kur objekti është i dëmtuar pavarësisht nga vlera e amortizimit për këto 2 lloj objektesh duhet te plotësohet kushti qe ato janë jashtë funksionit dhe ne to nuk ushtrohet asnjë veprimtari tjetër.
- Kur ka qene objekt i ish ndërmarrjeve shtetërore te cilat janë privatizuar(tërësisht ose pjesërisht ndërmarrja ose vete objekti) dhe është tërësisht i amortizuar (vlera e amortizimit mbi 80 % e vlerës fillestare dhe ndryshimeve përkatëse sipas pasqyrave kontabël) ose kur objekti është i dëmtuar pavarësisht nga vlera e amortizimit.

Për këto 2 lloj objektesh duhet te plotësohet kushti qe ato janë jashtë funksionit dhe ne to nuk ushtrohet veprimtari tjetër.

Për ato kategori ndërtesash banimi te cilat janë te regjistruara si seli te subjekteve tregtare, Taksa e Pasurisë përlloraget dhe paguhet si Kategoria II, Ndërtesa te tjera sipas rastit te ushtrimit te veprimtarisë duke u përjashtuar nga Kategoria e I, Ndërtesa Banimi.

Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor.

Afati i pagesës se kësaj takse për kategorinë Ndërtesa Banimi është data 30 Qershor

Afati i pagesës se kësaj takse për kategorinë Ndërtesa te tjera është brenda datës 20 Prill te vitit ushtrimor . Afati i pageses per detyrimet e lindura pas dates 30 Prill eshte 30 dite pas lindjes se detyrimit. Per subjektet e regjistruara rishtazi detyrimi tatimor to te llogaritet nga muaji korent i regjistrimit prane QKR.

Shpërndarja e njoftimeve te detyrimeve për kategorinë Ndërtesa banimi do te behet me Poste.

- Për kategorinë “ Ndërtesa banimi ” në rastin kur mungon dokumentacioni i vërtetimit të pronësisë, të dhënat për llogaritjen e taksës të merren në bazë të vetdeklarimit të llojit dhe sipërfaqeve të pasurisë nga qytetarët
- Per kategorie “ Ndertesa te tjera ” kur mungon dokumentacioni përkatës si dhe në rastet kur ka ndryshime në të dhënat e vetëdeklaruarua në formularin e mëparshëm.

Ky vetëdeklarim është i vlefshëm kur shoqërohet nga procesverbali i mbajtur ne vend nga grupi i inspektoreve te kontrollit (jo me pak se dy inspektore).

Afati i vetëdeklarimit për subjektet fizikë e juridikë është deri 31 Mars të vitit, për kategorinë “ Ndërtesa banimi ” afati është deri me 30 Qershor të vitit.

Formulari i vetëdeklarimit dorëzohet brenda afatit të përcaktuar nga qytetarët dhe nga personat fizikë dhe juridikë pranë Drejtorise së Taksave dhe Tarifave Vendore.

Në mungesë të të dhënave si rezultat i mosdeklarimit sipas afateve të përcaktuara si më lart dhe/ose në mungesë të dokumentacionit të pronësisë për subjektet taksapaguese të Kategorisë “ Ndërtesa Banimi ”, llogaritja e detyrimit bëhet:

- për kategorinë “ Ndërtesa banimi ”, mbi bazë fikse, ku madhësia e sipërfaqes së taksueshme është si më poshtë:
 - o Për ndërtesat e banimit të ndërtuara para vitit 1993 sipërfaqja e taksueshme është **100** m2.
 - o Për ndërtesat e banimit të ndërtuara mbas vitit 1993 sipërfaqja e taksueshme është **160** m2.
- për kategorinë “ Ndërtesa te tjera ” sipërfaqja e taksueshme vendoset ne baze te vlerësimit fizik nga një komision i posaçëm pranë organit tatimor i cili ngrihet me urdhër te Kryetarit te Bashkisë.

Perjashtohen nga taksa e nderteses familjet:

- Perfituese te ndihmes ekonomike
- Te semureve paraplegjik dhe tetraplegjike
- Familjet qe banojne ne shtepia ish pronaresh

Me kushtin qe keta te fundit te jene kryefamiljare dhe kur ne gjendjen e tyre civile nuk kane femije ne moshe apo persona te tjere te afte per pune.

Agjentet tatimor për vjeljen e taksës mbi Ndërtesën për kategorinë II “ Ndërtesa Banimi ” jane “ POSTA ” dhe Agjentet prane Qendrave Administrative te Bashkise Durrës

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesat për kategorinë “ Ndërtesa të Tjera ” është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë së Durrësit.

1.3. TAKSA E FJETJES NE HOTEL

Baza e taksës së fjetjes në hotel është çmimi i fjetjes, sipas rastit, për dhomë ose për person, për një natë. Janë subjekt i taksës te gjithë hotelet, motelet, stabilimentet turistik, pensionet, shtëpitë e pritjes, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër qe përdoret për këtë ushtrim veprimtarie.

Niveli i taksës është 2,5 për qind të çmimit të fjetjes.

Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të Bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli.

Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Durrës.

1.4. TAKSA E NDIKIMIT NE INFRASTRUKTURE NGA NDERTIMET E REJA

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet. Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat përkatëse përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Niveli i taksës sipas kategorive dhe nënkategorive për klasifikimin e investimeve, është si me poshtë:

KATEGORITE DHE NENKATEGORITE	% e NDIKIMIT
1. Objekte banimi	3 %
2. Objekte me funksione administrative, shërbimi etj.	3%
3. Objekte për qëllime publike kopshte, çerdhe, shkolla, spitale (private dhe shtetërore)	1%
4. Rehabilitim rrugësh, ujësjellës, kanalizime, etj.	1 %
5. Per ndertimin e rrugeve kombetare, porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ne energji	0,1%
6. Per ndrtesat,te cilat jane ne proces legalizimi,	0.5%

Per piken 5 vlera e 0,1 % nuk duhet te jete me pak se kostoja e reabilitimit te infrastruktures se demtuar

Struktura e ngarkuar për përlogaritjen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është Drejtoria e Urbanistikës.

1.5. TAKSA MBI KALIMIN E TË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Taksa paguhet nga personi qe kalon te drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme para kryerjes se regjistrimit ne përputhje me aktet ligjore ne fuqi.

Baza e taksës mbi kalimin e se drejtës se pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, sipas vertetimit të pronësise, pronësia e se cilës transferohet. Niveli i taksës caktohet në leke për metër katror të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, e cila në rolin e Agjentit të Taksës përfiton 3 % të shumës së arkëtuar.

1.6. TAKSA PËR ZËNIEN E HAPËSIRAVE PUBLIKE

Baza e taksës për zënie të hapësirave publike është sipërfaqja në m², e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi. Taksa llogaritet si detyrim mujor i taksapaguesit.

Kategoritë dhe nënkategoritë e Taksës për zënie të hapësirave publike jepen si në tabelën e mëposhtme:

KATEGORIA DHE NËNKATEGORITË		NIVELI TREGUES I TAKSËS/MUAJ
I.1	Zënie e hapësirës publike (përdorim trualli për avolina)	132 lekë/m ²
I.2	Spektakle ose panairë të ndryshme	132 lekë/m ²
I.3	Mallra jashtë vendit të tregtimit	132 lekë/m ²
I.4	Objekte të përkohshme me qëllim ushtrim aktiviteti tregtar, sipërfaqet e zëna me platforma ndërtimore, sipërfaqe të rrethuara me vazo me lule, bime dekorative, me kangjella, drurë dekorativ, kufizime me plastmasë dhe sende të tjera, etj të ngjashme me to.	132 lekë/m ²

Detyrimi i taksës për llogaritet si shumëzim i bazës (sipërfaqes) me nivelet treguese të saj.

Pagesa e Taksës për zënie të hapësirës publike:

- Për nënkategorinë I.1 pagesa do të bëhet në Drejtorinë e Taksave në baze të marjes m² të zëna nga subjekti për vendosjen e tavolinave jashtë ambientit ku ushtron aktivitetin kur ky ambient është prone publike.
- Për nënkategorinë I.2 pagesa do të bëhet me marrjen e Lejes për Ushtrimin e Aktivitetit, e cila do të jepet nga Drejtoria e Urbanistikës . Është kjo Drejtoria, e cila kryen dhe llogaritjen e detyrimit për lejen përkatëse.
- Për kategorinë I.2 dhe I.3 detyrimi është mujor dhe pagesa bëhet brenda datës 30 të muajit përkatës.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Taksës për zënien e hapësirës publike për kategorinë I.3 dhe I.4 është Drejtoria e Shërbimeve, pranë Bashkisë Durrës.

1.7. TAKSA E TABELES

Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet të cilët vendosin emërtimin e subjektit në njësinë ku zhvillojnë veprimtarinë .

Vendosja e tabelës me emrin dhe tregues të aktivitetit është e detyrueshme për të gjithë subjektet me përjashtim të ambulanteve, subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fushën e transportit dhe tregtareve që ushtrojnë aktivitet në tregjet e miratuara.

Kategoritë dhe niveli i taksës jepet si në tabelën e mëposhtme .

KATEGORITE	Niveli i Takses
1- Tabele per qellime identifikimi	120 leke / vit
2- Tabele per qellime reklamimi te thjeshta dhe elektronike	22.500 lek /m2/ vit deri ne siperfaqen 18m2 405.000 leke/vit per siperfaqe me temedha se 18m2
3-Tabele ne funksion te ekspozimeve te ndryshme te hapura,panaire,spektakle stenda reklamuese,banderola	1000 lek/m2/dit

Detyrimi për Taksën e Tabelës është vjetor.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse per piken 1 është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse per piken 2 dhe 3 është Drejtoria e Urbanistikës e cila jep dhe lejet per vendosjen e ketyre tabelave.

2 TAKSAT E PERKOHSHME

2.1. TAKSA E PËRKOHSHME E GJELBËRIMIT

Taksës së perkoheshme te gjelbërimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Durrësit. Kjo takse paguhet për çdo njësi ku ushtron aktivitetin subjekti.

Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të Taksës së Përkohshme për Gjelbërimin janë si më poshtë:

KATEGORITË	Niveli i Takses sipas llojit të aktivitetit
------------	---

Sistemin e taksave dhe tarifave vendore

		Biznes i Vogël (lekë/vit)	Biznes Madh+Vip (lekë/vit)
I	Çdo Familje	200 lekë/vit	
II	Veprimtari ekonomike të veçanta		
	Njësi prodhimi:	2.000	5.000
	- prodhim, përpunim produktesh farmaceutik	10.000	50.000
	Njësi ndërtimi		
	- Çdo kantier ndërtimi	0	70.000
	- Ndryshim destinacioni	0	5.000
	- Rikonstruksion banese, shtesa kati	5.000	70.000
	- Subjekte ndërtuese për selinë administrative	0	10,000
	Njësi shërbimi:		
	- Klinika mjekësore, laboratorë	4.000	7.000
	- Bar- Restorantet,	4.000	7.000
	- Fast-Food	3.000	4000
	- Njësi Shërbim Non-Stop (Pub, Diskotekë etj)	5.000	6.000
	Hotele	5.000	7.000
	- Lavazhe, karburante	13.000	70.000
	- Njësi shërbimi marangoz, rrobaqepës, këpucar, floktore, orëndreqës	1.500	5.000
	- Shkolla, kopshte, çerdhe, qendra kulturore, stadione, komplekse sportive, palestra fitnes, pishina, internet, salla koncerte-mbledhje e vidioteka	1.500	5.000
III	Njësi të tjera (që nuk përfshihen në kategoritë dhe nënkategoritë si më lart)	1.500	2.500

Detyrimi për Taksën e Gjelbërimit është vjetor. Për kategorinë II dhe III kur detyrimi lind 6/mujorin e dytë të vitit, subjektet paguajnë 50 % të detyrimit.

Afati i shlyerjes së detyrimit është data 20 Prill. Per subjektet te cilave detyrimi i lind pas 30 Prillit eshte 30 dite pas lindjes se detyrimit. Per subjektet e regjistruara rishtazi detyrimi tatimor do te llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit prane QKR.

Për nënkategorinë “ Njësi-çdo kantier ndërtimi ”, rikonstruksione te pjeseshme dhe ndryshim destinacioni llogaritja e taksës bëhet për periudhën nga momenti i ngritjes së kantierit të ndërtimit deri në momentin e dorëzimit nga subjekti pranë Bashkisë Durrës të kërkesës për leje shfrytëzimi.

- **Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Taksës së Përkohshme të Gjelbërimit për kategorinë njësi kantier ndërtimi, ndryshim destinacioni dhe rikonstruksione është Drejtoria e Urbanistikës.**
- **Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Taksës së Përkohshme për Gjelbërimin është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.**

- **Agjentet tatimor per vjeljen e Taksës së Perkoheshme të Gjëlberimit per kategorine e I “ Familje ” jane “ POSTA ” dhe Agjentet prane Qendrave Administrative te Bashkise Durrës.**

Perjashtohen nga Taksa e Perkoheshme e Gjëlberimit per ketegorine “ Familje ”

- **Perfituesit e ndihmes ekonomike**
- **Te semuret paraplegjik dhe tetraplegjik**

Me kushtin qe keta te fundit te jene kryefamiljare dhe kur ne gjendjen e tyre civile nuk kane femije ne moshe apo persona te tjere te afte per pune.

Të ardhurat e krijuara nga Taksa e perkoheshme e Gjëlberimit, përdoren vetëm për qëllimin për të cilin është vendosur kjo takse.

2.2. TAKSA E PËRKOHSHME E TREGUT

Taksës së Përkohshme të Tregut i nënshtrohen të gjithë subjektet, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në hapësirat e tregjeve publike të cilët janë në administrim të Bashkisë Durrës.

Baza e taksës së përkohshme të tregut është sipërfaqja në m², e cila vihet në shfrytëzim për tregtimin e artikujve të ndryshëm brenda territorit të tregut. Taksa llogaritet si detyrim mujor i taksapaguesit.

Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të Taksës së Përkohshme të Tregut janë si më poshtë:

Kategoritë dhe nënkategoritë	
Taksa e përkohshme e tregut	
- <i>fruta perime</i>	50 lek/m ² /ditë
- <i>bulmet, mish, peshk</i>	50 lek/m ² /ditë
- <i>artikuj industrial</i>	50 lek/m ² /ditë

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Taksës së Tregut është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, e përfaqësuar nga Administrata e Tregut Agrobuqësor.

3 TARIFAT VENDORE

3.1. TARIFA E RREGJISTRIMIT PER VEPRIMTARI TE NDRYSHME

Tarifa e regjistrimit paguhet vetëm një herë në momentin e kryerjes së regjistrimit fillestar të subjektit dhe veprimtarisë ekonomike të tij pranë organit tatimor vendor. Subjekti qe ka me shume se dy vendndodhje paguan vetem per adresen ku ka seline kryesore te aktivitetit.

Taksapaguesi regjistron çdo vendndodhje të biznesit pranë Bashkisë së Durrësit. Regjistrimi për herë të parë bëhet përpara se taksapaguesi të fillojë aktivitetin e biznesit të tij. Gjatë këtij regjistrimi taksapaguesi detyrohet të japë informacionet e mëposhtme:

- a) **Dokumentin e regjistrimit ne Qendren Kombetare te regjistrimit. (Nipt) te shoqeruar me Ekstraktin perkates.**
- b) **Fotokopje te Kartes se Identitetit dhe 2 foto;**
- c) **Adresën e vendndodhjes së biznesit;**
- d) **Llojin e biznesit që kryen në atë vendndodhje;**
- e) **Çdo të dhënë ose dokument tjetër, që mund të përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.**

Bashkia pajis me certifikate regjistrimi çdo taksapagues, i cili ka përfunduar procesin e regjistrimit ose te reregjistrimit për çdo vendndodhje te aktivitetit. Certifikata e regjistrimit përmban emrin e taksapaguesit, numrin e regjistrimit (kodin e bashkisë), NIPTIN e marre nga QKR, adresën e sakte te vendndodhjes se biznesit me te cilën lidhet dhe data e lëshimit te certifikatës. Kjo certifikate është e përhershme dhe merret ne momentin e krijimit dhe te regjistrimit për here te pare te taksapaguesit dhe nuk përsëritet çdo vit.

Taksapaguesit qe kryejnë biznese ne me shume se ne një vendndodhje brenda te njëjtës bashki, pajisen me certifikate regjistrimi për çdo vendndodhje biznesi.

Kategoritë dhe nivelet e tarifës së regjistrimit janë si më poshtë:

Kategoritë	Tarifa në lekë
Per veprimtari te persoPerppnave fizike ambulante	2.300
Per personat fizike,shtetereore e privat,vendas e te huaj	10.000
Për personat juridikë, shtetërorë e privatë, vendas e të huaj	15.000

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Tarifës së regjistrimit për veprimtari të ndryshme është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

3.2.TARIFA E PASTRIMIT DHE LARGIMIT TE MBETURINAVE

Tarifës së Pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Durrës, ne çdo njësi ku ushtrojnë aktivitetin.

Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të Tarifës së Pastrimit janë të shprehura si në Aneksin Nr. 2:

Pagesa për tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave është detyrim vjetor.

Për Kategorinë I “ Familjarët ” detyrimi është vjetor dhe kryhet brenda datës 30 Qershor.

Për Kategorinë II dhe III “ Biznesi ” detyrimi paguhet brenda datës 20 Prill të vitit . Kur detyrimi lind 6/mujorin e dytë të vitit, subjektet paguajnë 50 % të detyrimit. Afati i pageses per detyrimet e lindura pas dates 30 Prill eshte 30 dite pas lindjes se detyrimit. Per subjektet e regjistruara rishtazi detyrimi tatimor do te llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit prane QKR.

Të ardhurat e krijuara nga tarifat e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, përdoren vetëm për qëllimin për të cilin është vendosur kjo tarifë.

Përjashtohen nga tarifa e pastrimit:

Të gjithë institucionet shtetërore të cilat kanë një shërbim të tyre, për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave Ndërmarrjet Komunale .

- 1) Pensionistët
- 2) Veteranët
- 3) Invalidët e punës dhe të luftës.
- 4) Përfituesit e ndihmës ekonomike
- 5) Të verbrit
- 6) Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë
- 7) Te perndjekurit politike

Këto grupe duhet të dorëzojnë pranë zyrave të agjentit tatimor dëshminë e gjendjes së tyre dhe më konkretisht:

- Për pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 me kushtin që të jenë kryefamiljarë dhe pa persona të tjerë madhorë, përveç bashkëshortit ose bashkëshortes, në certifikatën familjare.
- Librezën e veteranit ose invalidit të luftës, statusin e invalidit të punës, statusin e të verbrit, të sëmurëve paraplegjikë e tetraplegjikë, vertetimin e te perndjekurit politik dhe vërtetimin nga Njësia Bashkiake për përfituesit të ndihmës ekonomike.

Për nënkategorinë “ Njësi-çdo kantier ndërtimi ”, rikonstruksione te pjeshme dhe ndryshim destinacioni llogaritja e taksës bëhet për periudhën nga momenti i ngritjes së kantierit të ndërtimit deri në momentin e dorëzimit nga subjekti pranë Bashkisë Durrës të kërkesës për leje shfrytëzimi.

- **Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Tarifës se Pastrimit dhe te Largimit te Mbeturinave për kategorinë në njësi kantier ndërtimi, ndryshim destinacioni dhe rikonstruksione është Drejtoria e Urbanistikës.**
- **Agjentet tatimor per vjeljen e Tarifes se Pastrimit dhe Largimit te Mbeturinave per familjaret jane “ POSTA ” dhe Agjentet prane Qendrave Administrative te Bashkise Durres.**
- **Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Tarifës se Pastrimit dhe Largimit te Mbeturinave për të gjithë subjektet e tjera është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.**
- **Struktura e ngarkuar per mbledhjen e Tarifes se Pastrimit dhe Largimit te Mbeturinave per kategorie III B eshte Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.**

3.3. TARIFA E PLAZHEVE PRIVATE

Kjo tarife aplikohet mbi të gjithë subjektet të cilat shfrytëzojnë sipërfaqen e rërës në vijën bregdetare për plazhe private gjatë periudhës së sezonit turistik.

Baza e tarifës është sipërfaqja e rërës në m².

Niveli i tarifës.....500 lek/m² ne muaj,ky te jete nivel dysheme ,te kete procedure konkurimi.

Struktura e ngarkuar për dhënien e lejes se shfrytëzimit te rërës dhe e mbledhjes se kësaj tarife është Drejtoria e Urbanistikës pranë Bashkisë Durrës

3.4. TARIFA PER LEJE PERDORIMI

1) Tarifa e lejes se perdorimit.....30 leke/m³

Struktura e ngarkuar për llogaritjen dhe e mbledhjen se kësaj tarife është Drejtoria e Urbanistikës pranë Bashkisë Durrës

3.5.TARIFA E PARKIMIT TE AUTOMJETEVE

3.5.1. Tarifa për parkimin e automjeteve në vendparkime publike me pagesë caktohet:

1) Autovetura.....100 lekë/ditë

2) Mikrobusët, Minibusë e të tjera të çdo lloji.....300 lekë/ditë

3) Kamionë

- deri 3.5 tonë.....100 lekë/ditë

- mbi 3.5 deri 8 tonë.....150 lekë/ditë

- mbi 8 deri në 14 tonë.....200 lekë/ditë

- mbi 14 tonë.....500 lekë/ditë

3.5.2. Për subjektet që kërkojnë parkim të rezervuar ranë institucioneve të tyre publike ose private në vende të miratuara për lejim parkimi:

Tarifa.....2000 lek/m² në vit

3.5.3. Tarife parkimi për subjektet qe krijojnë fluks automjetesh:

Kategoritë	Tarifa në lekë/vit
Bar-Bufe, Bilardo, pastičeri,byrek	5000
Restorant, Fast-Food,Piceri.	5000
Hotel,Motel,(Bar-Restorant).	10000
Lojëra Fati, Eurolloto	10000
Prodhim biznes i vogël	5000
Mermeri,tulla-gëlqere,etj .	5000
Agjenci –spedic., dog., funerale, auto-shkolle, etj.	10000
Treg.Teren-mater.Ndert,lavazh,Karb	10000

Sistemin e taksave dhe tarifave vendore

Ndertim	10000
Biznesi Madh	10000

Subjektet këtë tarifë e paguajnë vetëm një here dhe jo për çdo vendndodhje ku zhvillojnë aktivitetet.

Mbledhja e tarifës së parkimit të automjeteve për kategorinë 3.5.1 behet me Agjent Tatimor te kontraktuar nga Bashkia Durrës.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Tarifës së Parkimit të Automjeteve për kategorinë 3.5.2 është Drejtoria e Shërbimeve pranë Bashkinë e Durrës.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Tarifës së Parkimit për kategorinë 3.5.3 është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Durrës.

3.6. TARIFA E NDRIÇIMIT

Objekt i kësaj tarife do të jënë të gjithë familjaret, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Durrësit. Kjo takse paguhet për çdo njësi ku ushtron aktivitetin subjekti.

Subjektet Biznes i Vogel.....	3.000 leke ne vit
Subjektet Biznes i madh.....	5.000 leke ne vit
Familjare.....	500 leke ne vit

Detyrimi për taksën e ndriçimit është vjetor.

Kur ky detyrim lind në 6 muajin e dytë të vitit subjekti paguan 50 % të vlerës së këtij detyrimi

Detyrimet paguhet brenda datës 20 Prill të vitit fiskal. Kur detyrimi lind 6/muajin e dytë të vitit, subjektet paguajnë 50 % të detyrimit. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 Prill është 30 dite pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e regjistruara rishtazi detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit pranë QKR.

Të ardhurat e krijuara nga tarifa e Ndricimit, përdoren vetëm për qëllimin për të cilin është vendosur kjo tarifë.

Agjentet tatimor për vjeljen e Tarifës së Ndricimit për familjaret janë " POSTA " dhe Agjentet pranë Qendrës Administrative të Bashkisë Durrës.

Perjashtohen nga Tarifa e Ndricimit:

- Perfituesit e ndihmes ekonomike
- Te semuret paraplegjik dhe tetraplegjik

Me kushtin që këta të fundit të jënë kryefamiljare dhe kur në gjendjen e tyre civile nuk kanë femijë në moshe apo persona të tjerë të afte për punë.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e Tarifës është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Durrës.

3.7 TARIFA TE SHERBIMIT ADMINISTRATIV TE BASHKISE DURRES**3.7.1 TARIFA TE SHERBIMIT ARKIVOR**

Tërheqje dokumentesh dhe njehsim me origjinalin nga Arshiva e Bashkisë Durrës.....500 lekë/dokumenti

Struktura e ngarkuar e autorizimit të pagesës për tarifën e shërbimit arkivor do të jetë Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

3.7.2 TARIFA PER TRANSPORTIN PUBLIK

Nr.	Emertimi	Njesia	Tarifa ne lleke Afati 5 vjecar
I	<u>TRANSPORT UDHETARESH</u> <u>Brenda vendit</u>		
1	Licence per transport udhetaresh ne linje te rregullt qytetese.	Per linje	40000
2	- Certifikate per transport udhetaresh ne linje te rregullt qytetese.	Per mjet	5000
3.	Licence per transport udhetaresh ne linje te rregullt rrethqytetese.	Per linje	20000
4	- Certifikate per transport udhetaresh ne linje te rregullt rrethqytetese.	Per mjet	7500
5	Licence per transport udhetaresh ne linje te rregullt nderqytetese brenda qarkut.	Per linje	75000
6	- Certifikate per transport udhetaresh ne linje te rregullt nderqytetese brenda qarkut.	Per mjet	7500
7	Licence per transport udhetaresh ne linje te rregullt nderqytetese ndermjet qarqeve.	Per linje	75000
8	- Certifikate per transport udhetaresh ne linje te rregullt nderqytetese ndermjet qarqeve.	Per mjet	7500
9	Licence per transport udhetaresh	Per mjet	20000

Sistemin e taksave dhe tarifave vendore

	me taksi		
II	<u>TRANSPORT MALLRASH</u> <u>Brenda vendit</u>		
1	Licence per transport mallrash per te trete dhe me qira brenda vendit.	Per licence	40000
2	- Certificate per transport mallrash per te trete dhe me qira brenda vendit.	Ton/kapac mbajtes	100*
3.	Certificate per transport mallrash brenda vendit per llogari te vet. Certificate per terheqes.	Ton/kapac mbajtes	100*
		Per terheqes	7500
III	<u>SHERBIME TRANSPORTI</u>		
1.	Licence per agjenci transporti udhetaresh dhe taksi brenda vendit.	Per Licence	15000
2	Licence per agjenci transporti nderkombetar udhetaresh	Per Licence	40000
IV	<u>VEPRIMTARI TE TJERA</u>		
1	<u>Autorizim I perkohshem nje mujor</u>	Per autorizim	2000

Shenim.Per publikate me te njejten permbajtje dhe afat vlefshmerie paguhet 30% e vleres se plote.

Struktura e ngarkuar per leshimin e autorizimit te pageses per Tarifen e Transportit Publik eshte Drejtoria Sherbimeve.

3.7.3 TARIFA E AUTORIZIMEVE PER TREGTIM KARBURANTI

Nr	Emertimi	Njesia	Tarifa neLeke
1	Autorizim per funksionimin si stacion shitje te karburanteve,gazi te lengshem te naftes dhe vajrave lubrifikant	Per autorizim	100.000
2	Autorizim per funksionimin si njesi te shitjes te gazit te lengshem te naftes per perdorim rezidencial	Per autorizim	50.000

Shenim.Per publikate me te njejten permbajtje dhe afat vlefshmerie paguhet 30% e vleres se plote.

Per perseritjen periodike te autorizimit tarifa e pageses eshte 50% e vleres se autorizimit fillestar.

Struktura e ngarkuar per leshimin e autorizimit te pageses per kete tarife eshte Drejtoria Sherbimeve.

3.7.4 TARIFA E AUTORIZIMEVE PER QARKULLIM NE QYTET

Nr	Emertimi	Njesia	Tarifa ne leke
1	Autorizim per levizje kunder sinjal rrugor "Ndalim qarkullimi per kamione" me kapacitet maksimal (3500-8000)kg	Per mjet	5.000
2	Autorizim per levizje kunder sinjal rrugor "Ndalim qarkullimi per kamione" me kapacitet maksimal (8001-14000)kg	Per mjet	10.000
3	Autorizim per levizje kunder sinjal rrugor "Ndalim qarkullimi per kamione" me kapacitet maksimal mbi 14000 kg	Per mjet	15.000

Shenim. Keto Autorizime e kane afatin kohor jo me shume se gjashte muaj.

Per dublikate me te njejten permbajtje dhe afat vlefshmerie paguhet 30% e vleres se plote.

Struktura e ngarkuar per leshimin e autorizimit te pageses per kete tarife eshte Drejtoria Sherbimeve.

3.7.5 TARIFA PER DHENIE LEJE USHTRIM VEPRIMTARIE

Nr	Emertimi	Njesia	Tarifa ne leke
1	Leje per ushtrim veprimtarie si Lavazh	Per leje	10.000
2	Leje per ushtrim veprimtarie si Parking per automjete	Per leje	10.000
3	Leje per ushtrim veprimtarie Parkim te miratuar	Per leje	5.000
4	Leje per ushtrim veprimtarie tregtim ambulant	Per leje	5.000
5	Leje per ushtrim veprimtarie tej kohes normale te punes me orar te kufizuar,jo me shume se nje vit	Per leje	5.000
6	Leje per ushtrim veprimtarie tej kohes normale te punes 24h,nonstop,jo me shume se nje vit	Per leje	10.000

Shenim.Per dublikate me te njejten permbajtje dhe afat vlefshmerie paguhet 30% e vleres se plote.

Struktura e ngarkuar për leshimin e autorizimit të pagesës për tarifën për dhënie leje ushtrim aktiviteti do të jete Drejtoria e Shërbimeve .

3.7.6 TARIFA TE SHERBIMIT VETERINAR

I. Leje sanitaro-veterinare për objektet

- a. Miratim për ndërtim : Thertore, Stabilimente te përpunimit te produkteve shtazore, frigoriferë magazinues, fabrike përpunim shqime blegtorale, fabrike dhe

Sistemin e taksave dhe tarifave vendore

depo lëkuresh, stalla kafshësh, klinika dhe farmaci veterinare.....1.000lek(projekti)

- b. Leje per venie ne funksinim: Thertore, Stabilimente te perpunimit te produkteve shtazore, frigorifere magazinues, fabrike perpunimi ushqime blegtorale, fabrike dhe depo lekuresh, stalla kafshesh klinika dhe farmaci veterinare.....1.000 leke/vit
- c. Leje per: Njesi tregtare dhe Reparte te supermarketeve ku tregtohen produkte shtazore (mish, qymesht, peshk,veze e nenproduktet e tyre) si dhe njesi tregtare te kafsheve te gjalla.....500 leke/vit
- d. Leje per mjet transporti te produkteve blegtorale e te detit, lekureve e kafsheve te gjalla.....1. 500 leke/vit

II. Tarife per cdo bageti te therur

- a. Per : gjedh, kuaj, derra.....50 leke/kre
- b. Per : dhen, te dhirta.....20 leke/kre

III. Sherbim veterinar per kontrollin dhe leje konsumi te: kafsheve para therjes,mishit, peshkut, e nenprodukteve te tyre

- a. Kontrolli I gjedheve e kuajve para therjes.....20 leke/kre
- b. Kontrolli i derrave dhe te imtave para therjes..... 10 leke/kre
- c. Kontrolli i mishit per nje lope, ka, kale.....100 leke/kre
- d. Kontrolli i mishit per nje viç, mez.....30 leke/kre
- e. Kontrolli i mishit per nje te imte dhe derr.....20 leke/kre
- f. Kontrolli i mishit te pulave te therura.....5 leke/kre
- g. Kontrolli peshkut e prodhimeve blegtorale-deri 100kg..... 50 leke
- h. Kontrolli peshkut e prodhimeve blegtorale mbi 100 kg.....100 leke

IV. Çertifikata veterinar

- a. Leshimi çertifikates per lejen e konsumit te pikave 1deri 8 te sherbimit veterinar per kontrollin e kafsheve, mishit, peshkut dhe prodhimeve te tyre.....50 leke
- b. Leshimi i çertifikates per eksportimin e kafsheve, shpendeve.....500 leke
- c. Leshimi i çertifikates per eksportin e peshkut dhe prodhimeve blegtorale.....1000 leke
- d. Leshimi i çertifikates se importit (Konvertimi i çert.se huaj ne shqiptare).....1000 leke

V. Masa profilaktike

- a. Vaksininim: kuaj.....200 leke/kre
- b. Vaksininim:gjedh,derra.....100 leke/kre
- c. Vaksininim: te imta.....50 leke/kre
- d. Vaksininim: shpendesh individualisht.....5 leke/kre
- e. Vaksininim me hidrovaksine.....200 leke/kre
- f. Dezinfektim i mjediseve.....100 leke/m2
- g. Derratizim i mjediseve.....100 leke/m2

Struktura e ngarkuar për lëshimin e autorizimit të pagesës për Tarifën e Inspektoratit Veterinar është Sektori Veterinar pranë Drejtorise se Shërbimeve.

3.7.7. TARIFA E URBANISTIKES

Nr.	EMERTIMI	NIVELI
1	Terheqja dokumentash te njesuara me origjinalin	500 lek/dokumentash
2	Terheqja praktike te njesuara me origjinalin	3.000 lek/praktike
3	Kontrolli i piketimit të objekteve deri ne 3 kate mbi toke.	10.000 lek
4	Kontrolli i piketimit të objekteve mbi 3 kate mbi tok	15.000 leke
5	Kontrolli pas përfundimit të themeleve deri ne 3 kate mbi toke	10.000 leke
6	Kontrolli pas përfundimit te themeleve mbi 3 kate mbi tok	15.000 leke
7	Kontrolli pas përfundimit të karabinasë per te gjithë objektin	3000 leke/per kat
8	Akt kontroll per përfundim punimesh te rifiniturave te struktures te re per objekte deri ne 3 kat	8.000 leke
9	Akt kontroll per përfundim punimesh te rifiniturave te struktures te re per objekte mbi 3 kat	1.500 leke/per kat
10	Azhornimi i relievit	50 leke/m2
11	Tarife per zbardhje dosjesh per objekte deri ne 3 kate	10.000 leke
12	Tarife per zbardhje dosjesh per objekte mbi 3 kate	25.000 leke
13	Akt kontroll per objektet qe paisen me leje ndertimi	5.000 leke
14	Akt kontroll per objektet qe paisen me leje zhvillimi dhe ndertimi	10.000 leke
15	Tarifa per shqyrtim kerkese per leje zhvillimi	

V.:Tarifa per shqyrtimin e kerkeses per leje zhvillimi llogaritet mbi bazen e siperfaqes se ndertimit per te cilen pergatitet kerkesa per zhvillim.

Struktura e ngarkuar për lëshimin e autorizimit të pagesës për Tarifat e Urbanistikës është Drejtoria e Urbanistikës.

3.7.8 TARIFA PER SHERBIME NE DREJTORINE E TAKSAVE

a) Lëshim Dublikate Certificate.....1.000 leke

3.8. TARIFA TË INSTITUCIONEVE TË VARËSISË**3.8.1 NDERMARJA SHERBIMEVE KOMUNALE DHE NDERRMARJA PLAZH**

a) Tarifa për largimin e mbeturinave voluminoze (inerte, dhera, skeletike etj)...1.500 Lekë/Ton

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj Tarife është NSHK dhe NKP

3.8.2. QENDRA KULTURORE DURRES

a. *Tarifa e dhënies në përdorim të sallës madhe*
Aktivitete artistike30.000 leke/ora

- Aktivitete sociale, politike, fetare20.000 leke/ora
- b. Tarifa e dhënies në përdorim të Odeonit**
- Aktivitete artistike.....15.000 leke/ora
 - Aktivitete sociale, politike, fetare.....10.000 leke/ora
 - Tarifa e dhënies në përdorim të mini-sallave.....5.000 leke/ora
 - Tarifa e dhënies në përdorim të Hollit10.000 leke/ora
 - Tarifa e dhënies në përdorim të Sallës së Galerisë.....5.000 leke/ora
 - Për përdorim për ekspozita disa ditore3.000 lekë/ditë
- c. Tarifa dhënies përdorim të përkohshëm**
- skenës lëvizëse(strukturë metali, foni , ndriçim).....50.000 lekë/ora
 - Tarifa dhënies përdorim fonisë.....10.000 lekë/ora
 - Tarifa për trupat teatrore në varësi të Bashkive.....5.000 leke/ora
 - Tarifa e dhënies së fonisë për trupat teatrore në varësi të Bashkive.....5.000 leke/ora
 - Tarifat për Tetarin Kombëtar.....1 EURO

1.1 Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifës është Qendra Kulturore Durrës.

3.8.3. KLUBI SHUMESPORTEVE

- a. Tarifë e përdorimit të sallës madhe**
- spektakle, aktiv. Kulturore.....10.000 lekë/orë
 - politike, shoqërore, sociale.....30.000 leke/aktivitet
 - Tarifë e përdorimit të pishinës.....100 lek/person/orë

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifave është Klubi Shumë-sporteve Teuta.

3.8.4 QËNDRA EKONOMIKE E ARSIMIT

Për fëmijët që frekuentojnë kopshtet dhe çerdhet paguhet tarifa :

Emërtimi tarifës	Kopshte	Çerdhe
Tarifë për Ushqimin	125 lekë/ditë për fëmijë	125 lekë/ditë për fëmijë
Tarife fikse	300 leke/muaj për fëmije	300 leke/muaj për fëmije

Detyrimi mujor përbëhet nga Tarifa Fikse dhe Tarifa për Ushqimin, ku kjo e fundit përlogaritet me nivelin ditor të tarifës dhe ditët e frekuentimit të fëmijës në çerdhe/kopshte gjatë 1 muaji.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifave është Qendra Ekonomike Arsimit Durrës

4 ANKIMIMI

- Taksapaguesi ka te drejte te ankohet me shkrim per menyren se si jane vleresuar detyrimet e tij te taksave nga zyra e taksave.
- Cdo ankim paraqitet prane Kryetarit te Bashkise brenda 30 diteve nga marrja dijani per aktin administrativ. Kryetari (komisioni i ngritur prej tij) shqyrton ankimin dhe merr vendim brenda 30 diteve nga casti i depozitimit.
- Ankimimi ndaj ketij vendimi ne gjykate behet brenda 30 diteve nga casti i marrjes ne dijani per vendimin e mesiperm.

ANEKSI 1

Nr	XHIRO/ AKTIVITET	Deri 2000	2000-3000	3000-4000	4000-5000	5000-6000	6000-7000	7000-8000
a)	SHITJE ME PAKICË	45	68	83	98	113	128	143
a.1	Bulmet, mish, peshk							
a.2	Fruta, perime, ushqimore							
a.3	Artikujt industrialë (veshje, parfumeri, argjendari, etj)							
a.4	Bar, restorant, Pub, diskoteka, lojëra fati							
a.5	Fast food, kafe internet							
a.6	Etj te ngjashme me to							
a.7	Tregti me rulot							
a.8	Tregtare ne tregje te miratuara nga Bashkia	8						
b)	SHITJE ME SHUMICË	45	68	83	98	113	128	143
b.1	Magazina, dyqane etj te cilat realizojne shitje me shumice							
c)	PRODHIM	28	47	60	72	85	98	110
c.1	Perpunim duralumini, metalesh, druri, tapicerie etj te ngjashme me to							
c.2	Prodhim tulla, tjegulla, blloqe betoni, furra gelqereje, etj, te ngjashme me to							
c.3	Prodhime ushqimore, buke, embelsirash, mishi, peshku, bulmeti etj te ngjashme me to.							
c.4	prodhim konfeksione, etj te ngjashme me to							
c.5	Shtypshkronja etj te ngjashme me to							
c.6	Prodhim perpunim produkte farmaceutike etj te ngjashme me to							
c.7	Zenie peshku							

Sistemin e taksave dhe tarifave vendore

d)	SHËRBIME	25	48	63	78	93	108	123
d.1	Riparimi i artikujve elektro-shtepiake, radio televizore, frigorifere, lavatriçe, manjetofon, paisje fonie e te tjera te ngjashme me to.							
d.2	Sherbime fotokopimit, sallon bukurie, autoservise, kurse per makina (autoshkolla) per traktore, per kompjuter e per parukeri, agjensi doganore, agjensi kembimi valute, agjensi turizmi, motele, pikat e sherbimit te makinave(autoservis), parkimi i makinave, lavaxerite, pastrimi kimik, sherbime te rojeve civile, sallat e lojrave te ndryshme (gjimnastike, aerobie, cirqe, kende lojrash per femije, ping pong, etj.) e te tjera sherbime te ngjashme me sherbimet e lartepemendura.							

e)	PROFESIONE TE LIRA	42	66	83	99	116	132	149
e 1)	Avokatet, noter, mjek, mjeku-laborant, stomatologu, farmacisti, ekonomisti kontabel te miratuar, eksperti kontabel te autorizuar, mesuesit, veterinerit, agronomit, botuesit, inxhinier, arkitekti, projektuesi, e te tjera profesione te lira te cilat ushtrohen ne njesi fikse apo ne ambiente te ndryshme.							
e 2)	Galerite e artit te piktoreve, skulptoreve dhe artisteve te tjere qe prodhojne dhe tregtojne objekte artistike							
e 3)	Institucionet jopublike te edukimit (shkollat, kopshtet apo cerdhet), sherbimet ne klinikat e specialiteteve te ndryshme mjekesore, sherbimet ne laboratore diagnostifikimi etj ne rastet kur nuk e kalojne kufirin e regjistrimit ne TVSH.							
f)	AMBULANT	8						
f 1)	Subjekte qe nuk kane nje vendndodhje fikse, tregtia ambulante ne tregje publike dhe private.							
g)	TRANSPORT							
	Transport Pasagjeresh							
	Automjete deri 5 vende	17.5						
	Automjete 6 – 9 vende	35						
	Automjete 10 – 25 vende	40						
	Automjete 26 – 42 vende	45						
	Automjete mbi 42 vende	48						
g 2)	Transport mallrash							
	Automjete deri 2 ton	28						
	Automjete 2 – 5 ton	40						

Sistemin e taksave dhe tarifave vendore

	Automjet 5 – 10 ton	48					
	Automjet 10 – 16 ton	50					
	Automjete mbi 16 ton	75					
G 3)	Transport Ujor						
	Transport detar brenda vendit	55					
	Transport ne liqene brenda vendit	48					
	Varka per shetitje	15					

ANEKSI 2

KATEGORITE E BAZES DHE NIVELET E TARIFES SE PASTRIMIT

ne lekë

Nr.	Aktivitet	Niveli i Tarifës	Niveli i Tarifës
		Biznes i Vogël	Biznes i Madh+ Vip
I	KATEGORIA E FAMILJAREVE	1.000	
II	KATEGORIA E BIZNESIT		
1	Shitje me pakic shumice		
	Bulmet, mish, peshk	20.000	20.000
	Fruta, perime, ushqimore	15.000	15.000
	Artikujt industrialë (veshje, parfumeri, argjendari, etj)	10.000	20.000
	Pub, diskoteka, lojëra fati	20.000	20.000
	Bar, restorant, Fast food, kafe internet, Etj te ngjashme me to	20.000	20.000
2	Prodhim		
	Subjekte qe ushtrojne aktivitet ne fushen e Prodhimit	20.000	70.000
	Zenie Tregti Peshku	5.000	20.000
	Prodhime ne fushen e artit (kinomatografia Radio TV etj te ngjashme me to)	20.000	20,000
3	NDERTIM		
	Subjekte Ndertuese	100.000	100.000
	Ndryshim destinacioni	20.000	30.000
	Rikonstruksione te pjesshme dhe shtesa kati	40.000	50.000
	Subjekte ndertuese per seline administrative	50.000	50,000
4	Shërbime	5.000	20.000
	Profesione të lira	5.000	10,000
5	Insitucione arsimore, kulturore, Sportive etj		
	Universitete, Shkollat, kopshtet apo cerdhet, konvikte, kolegje, kinema,	10.000	20,000

Sistemin e taksave dhe tarifave vendore

	Insitucione sportive, ekspozita dhe panaire te ndryshme.	20.000	20,000
	Hotele, Motele, Komplekse Turistike, Pensione	5,000 leke + 1000 leke/dhome/ vit	20,000 leke + 1000 leke/dhome/vit
	Shtepi pushimi, shtepi femijesh. Spitale, maternitete per cdo dhome		
	Private	10,000 leke + 1000 leke/dhome/vit	20,000 leke + 1000 leke/dhome/vit
	Shteterore	5.000 + 500/lek/dhom/vit	10,000 leke + 500 leke/dhome/vit
6	Ambulant	1.500	
III	Automjetet		
	Transport Madhrash	4.000	5.000
	Transport udhetare	4.000	15.000

Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe te gjitha Drejtorite e Bashkise Durres si dhe Institucionet ne varesi te saj.

Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

ZV / KRYETAR

ZHULJEN VARFAJ

**DR. DR. TAKSAVE DHE
TARIFAVE VENDORE**

ARDIANA KACERJA

DR. DR. LIGJORE

ERINA REXHEPI

DR. DR. SHERBIMEVE

ZV / KRYETAR

ARDIAN CELA

DR. DR. EKONOMIKE

DRITA ALIKAJ

DR. DR. URBANISTIKES

ADHURIM QEHAJAJ

DR. DR. A.K.R.S.KOM.FETARE

BESNIK KERTUSHA

ADRIAN GURRA

DR.DR.BURIMEVE NJEREZORE

DR.DR.SHERBIMIT SOCIAL

DRITA ZENELI

MEME XHAFERAJ

DR.DR.POLITIKAVE TE ZHVILLIMIT

SHEF I SEK. REGJISTRIMIT

SOKOL KOKOMANI

LULJETA BEQIRAJ

DR.DR.ADUDITIT TE BRENDSEHEM

KRYETARI I BASHKISE

LULJETA ZAHIRI

VANGJUSH DAKO

SEK.KESHILLIT BASHKIAK

MELIHA MALOKU

